

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Kontabiliteti Menaxherial
(zgjidhjet)

P2

Nr.

FLETË PROVIMI

Udhëzime/:

1. MOS E HAPNI DERISA T'IU LEJOHET PREJ
MBIKËQYRËSIT

.

2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA
PYETJEVE

3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË

4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË
FLETË TË KËTIJ PROVIMI.

Data XX.10.2019

PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	<u>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK-PIKËT E DHËNA</u>
1. Problemi 1	20	
2. Problemi 2	20	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problem 5	20	
Total	100	

Problem 1 20 pikë

- (a) Supozoni që materiali direkt (MD) "TESLA" përdoret nga kompania ABC në prodhim e produktit "ARIZONA". Kërkesa për Produktin për vitin kontabël 2019 parashikohet të jetë 100,000 njësi.

Secila njësi e përfunduar e produktit "ARIZONA" përmban 0.1 KG të Materialit "TESLA". Gjatë prodhimit ka gjithmonë një humbje normale prej 15% të materialeve të përdorura. Nuk planifikohet asnjë ndryshim në nivelet e mbajtura të stoqeve të Produktit "ARIZONA" në vitin 2019, megjithatë planifikohet një zvogëlim prej 10,000 KG në stoqet e Materialit "TESLA".

Shfrytëzoni informatat e dhëna më lartë, për t'iu përgjigjur kërkesës si në vijim.

Kërkohet:

Llogarisni sasinë e Materialit Direkt "TESLA" që duhet të blihet (tregoni kalkulimet e juaja).

(4 pikë)

- (b) Materiali "CCC" përdoret në prodhimin e Produktit "YYY" dhe në disa produkte të tjera. Kërkesa totale vjetore për Materialin "CCC" është 50,000 litra, dhe kjo sasi përdoret në mënyrë të njëtrajshme çdo vit (1 vit = 50 javë).

Kostot e porositjes së stoqeve dhe mbajtjes së tyre janë si vijon:

Porositja € 111 për porosi

Mbajtja € 0.10 për litër në vit

Për stoqet e Materialit "CCC" duhet të ruhet një nivel i caktuar i sigurisë prej 1,500 litrash dhe koha mesatare që nevojitet për të marrë në dorëzim një porosi (pra intervali kohor midis dhënies së një porosie për materiale dhe dorëzimit të tyre) është 2.1 javë.

Kërkohet:

Për Materialin "CCC" llogarisni:

- (i) Sasinë e porosisë ekonomike, duke përdorur formulën $\sqrt{[(2CoD) \div Ch]}$; (4 pikë)
- (ii) Nivelin pas të cilit duhet të porositet përsëri (supozoni se 1 vit = 50 javë); (4 pikë)
- (iii) Koston totale vjetore të porositjes së stoqeve të materialit; (4 pikë)
- (iv) Koston totale vjetore të mbajtjes së stoqeve të materialit. (4 pikë)

(20 pikë)

Zgjidhja 1

1(a) Sasia e blerë për përdorimin e materialit "TESLA" = $(0.10 \div 0.85) \times 100,000$
= **11,765 KG**

apo

$0.1\text{KG} \times 100,000 = 10,000 \text{ KG}$, $10,000\text{KG} : (100\% - 15\%) = \mathbf{11,765 \text{ KG}}$

Blerja totale = $11,765 \text{ KG} - 10,000 \text{ KG}$

= **1,765 KG**

(b) (i) Sasia e porosisë ekonomike për Materialin "CCC"

= $\sqrt{[(2 \times 111 \times 50,000) \div 0.1]}$

= **10,536 litra**

(ii) Niveli i ri - porositjes së Materialit Y

= $[(50,000 \div 50) \times 2.1] + 1,500$

= **3,600 litra**

(iii) Kostoja vjetore e porositjes për Materialin Y

= $(50,000 \div 10,536) \times 111$

= **€ 527**

(iv) Kostoja vjetore e mbajtjes për Materialin Y

= $[(10,536 \div 2) + 1,500] \times 0.1$

= **€ 677**

Problemi 2 20 pikë

(a) Përshkruani plotësisht KATËR karakteristikat e informacioneve të dobishme.

(4 pikë)

(b) Kostot që kanë të bëjnë me qarkullimin e punonjësve [kur punonjësit e lënë punën] mund të klasifikohen si:

- (i) kostot e zëvendësimit
- (ii) kostot e parandalimit.

Kërkohet:

Jepni DY shembuj të kostove brenda për brenda SECILIT nga klasifikimet dhe parashtoni formulën e përdorur për të llogaritur normën e qarkullimit të punës. (6 pikë)

(c) Një kompani prodhon një produkt të vetëm me normën 25 njësi për orë të punës direkte. Nga 660 orët e punës direkte që ishin buxhetuara për t'u punuar gjatë periudhës, u punua aktualisht 640 orë dhe u prodhuan 16,390 njësi.

Kërkohet:

Llogarisni koeficientët e mëposhtëm për periudhën:

- (i) efikasiteti;
- (ii) kapaciteti;
- (iii) vëllimi i prodhimit. (10 Pikë)

Zgjidhja 2

- 5(a) Karakteristikat e informacioneve të dobishme:
- (a) **Përkatësia.** Informacionet e paraqitura përmbushin nevojat e përdoruesve.
 - (b) **Besueshmëria.** Informacionet nuk përmbajnë anomali ose shtrembërime materiale.
 - (c) **Pasqyrimi i vërtetë.** Informacionet japin detaje të plota të efekteve të tyre mbi pasqyrat financiare dhe kontabilizohen vetëm nëse efektet e tyre financiare janë të qarta.
 - (d) **Neutraliteti.** Informacionet nuk përmbajnë shtrembërime.
 - (e) **Plotësia.** Informacione duhet të paraqesin një figurë të plotë të aktiviteteve ekonomike të entitetit.
 - (f) **Krahasueshmëria.** Informacionet duhet të përgatiten në mënyrë konsistente në mënyrë që të mund të bëhen krahasime të vlefshme me informacionet e periudhave të mëparshme dhe me informacionet e entiteteve të tjera.
 - (g) **Kuptueshmëria.** Informacionet mund të jenë të vështira për t'u kuptuar nëse nuk janë të plota, megjithatë hollësitat e tepruara mund të krijojnë ngatërresa.

- (b) Kostot e qarkullimit të punonjësve:

Kostot e zëvendësimit janë kostot që ndodhin për të rekrutuar punonjës të rinj. Këtu përfshihen gjëra të tilla si reklamimi, intervistimi, trajnimi dhe mungesa e efikasitetit të punonjësve ndërsa mësojnë punën e re.

Kostot e parandalimit janë kostot që ndodhin në mënyrë që të mbahen në punë punonjësit. Këtu përfshihen gjëra të tilla si mjedisi i argëtimit të punonjësve, mjedisi i punës, skemat e pagesave dhe të pensioneve.

Norma e lënies së punës për një periudhë të caktuar mund të llogaritet si:

$$\frac{\text{Numri i punonjës të zëvendësuar (ose numri i punonjësve që kanë lënë punën)} \times 100\%}{\text{Numri mesatar i punonjësve}}$$

- (c) Koeficientët e prodhimit: llogaritjet:

Orët e pritshme të prodhimit [outputit] të pritshëm = $16,390 \text{ njësi} \div 25 \text{ njësi/orë} = 655 \text{ } \pounds$ orët e punës direkte

Koeficienti i efikasitetit:

$$\frac{\text{Orët e pritshme të outputit aktual} \times 100\%}{\text{Orët aktuale të punuara}} = \frac{655 \text{ } \pounds \times 100\%}{640} = 102 \cdot 4\%$$

Koeficienti i kapacitetit:

$$\frac{\text{Orët aktuale të punuara} \times 100\%}{\text{Orët e buxhetuara}} = \frac{640 \times 100\%}{660} = 97 \cdot 0\%$$

$$\frac{\text{Orët e buxhetuara}}{\text{Orët e pritshme të outputit aktual}} = \frac{660}{655 \text{ } \pounds} = 100 \cdot 8\%$$

Koeficienti i vëllimit të prodhimit :

$$\frac{\text{Orët e pritshme të outputit aktual} \times 100\%}{\text{Orët e buxhetuara}} = \frac{655 \text{ } \pounds \times 100\%}{660} = 99 \cdot 3\%$$

$$\frac{\text{Orët e buxhetuara}}{\text{Orët e pritshme të outputit aktual}} = \frac{660}{655 \text{ } \pounds} = 100 \cdot 8\%$$

Problemi 3 (20 pikë)

Feather Friends LLC, është një korporatë e cila merret me prodhimin e orendive shtëpiake. Cmimi i shitjes për produktin 'XIX' është 15€/njësi. Kostot variabile për njësi janë 6€/njësi, ndërsa ato fikse janë 180,000€ për vit.

Kërkohet:

- a) Përlllogarisni raportin (marzhën) e kontributit të shitjeve (6 pikë)
- b) Përlllogarisni dhe komentoni pikën rentabël në EURO dhe në njësi (6 pikë)
- c) Supozoni që kërkesa për shitje e produktit "XIX" është parashikuar të rritet për 45,000€ gjatë vitit të ardhshëm. Për sa EURO duhet të rritet fitimi operativ (apo humbja operative), duke supozuar që kostot fikse mbesin të pandryshueshme? (8 pikë)

Zgjidhja e problemit 3

1. Koeficienti kontribut/shitje = 60%:

Cmimi shitjes€15 100%

Kosotot variabile € 6 40%

Marzha kontributit € 9 60%

2. Pika rentabël

$$= 180,000€ / 60\% = 300,000€$$

Në njësi = $300,000€ / 15€ = 20,000$ njësi.

Pra, korporata duhet të ketë shitje 300,000€ apo 20,000 njësi në vit, për të operuar me zero fitim operativ.

3. $€45,000$ rritja e shitjeve $\times 60\%$ Marzha kontributit = $€27,000$ marzha e rritur e kontributit. Pasi që kostot fikse mbesin të njëjta, atëherë fitimi operativ gjithashtu do të rritet për **€27,000**.

Problemi 4 (20 pikë)

(a) Përkufizoni termin 'faktor kufizues' dhe jepni 4 shembuj.

(4 pikë)

(b) Një kompani prodhon tre produkte (A, B dhe C). Të gjithë punonjësit direktë janë të të njëjtës gradë dhe paguhen me €10 në orë. Pritet që të ketë një mungesë të punonjësve direktë në periudhën e ardhshme, e cila pritët të pengojë që kompania të arrijë shitjet e synuara të mëposhtme:

Produkti A 1,000 njësi

Produkti B 9,000 njësi

Produkti C 10,700 njësi

Çmimet e shitjes dhe kostot janë:

	Produkti A	Produkti B	Produkti C
	€ për njësi	€ për njësi	€ për njësi
Çmimet e shitjes	100.00	69.00	85.00
Kostot variabile:			
Të prodhimit*	51.60	35.00	42.40
Jo të prodhimit	5.00	3.95	4.25
Kostot fikse:			
Të prodhimit	27.20	19.80	21.00
Jo të prodhimit	7.10	5.90	6.20
*përfshin kostot e punonjësve direktë	24.20	16.50	17.60

Kostot fikse për njësi bazohen mbi nivelin e synuar të shitjeve. Kostot fikse nuk do të jenë më të ulëta në qoftë se prodhimi dhe shitjet janë në një nivel më të ulët.

Kërkohet:

(i) Përcaktoni planin e prodhimit i cili do të maksimizonte fitimin në periudhën e ardhshme, në qoftë se orët direkte të punës së punonjësve direktë kapin totalin prej 35,000 orë. (11 pikë)

(ii) Llogarisni fitimin total neto në periudhën e ardhshme duke u bazuar në planin e prodhimit të përpiluar në (b) më sipër. (5 pikë)

(20 pikë)

Zgjidhja e problemit 4

2(a) Faktori kufizues

Faktori kufizues është faktori (një aspekt i biznesit ose burimeve) i cili kufizon aktivitetet e një organizate afariste. Për shumicën e bizneseve shpesh ky është *niveli i shitjeve* që mund të arrihet por ka edhe raste të tjera kur biznesi mund të kufizohet nga mungesat e njërit prej burimeve të përdorura (si në situatën e përshkruar në pjesën tjetër të kësaj pyetjeje, ku *mungesa në punë* parandalon biznesin të arrijë potencialin e vet të shitjeve). Shembuj të tjerë të faktorëve kufizues përfshijnë *kapacitetin e makinerive* (ndërsa prodhimi kufizohet për shkak të kohës së përdorur nga makineritë për prodhim) dhe *kufizimet në materiale* (ndërsa prodhimi kufizohet për shkak të mungesës së ofertës për një input që kërkohet në procesin e prodhimit). Kufizime tjera mund të jenë edhe *mungesa e financave, resurseve humane*, etj.

(b)(i) Plani i prodhimit

	Produkti A	Produkti B	Produkti C
	€ për njësi	€ për njësi	€ për njësi
Çmimi i shitjes	100.00	69.00	85.00
Kostot variabël	56.60	38.95	46.65
	-----	-----	-----
Kontributi	43.40	30.05	38.35
	-----	-----	-----
	43.40	30.05	38.35
Kontributi për çdo € të kostos së punës direkte*	-----	-----	-----
	24.20	16.50	17.60
	= € 1.793	= € 1.821	= € 2.179
<i>Prioriteti i prodhimit</i>	3	2	1
	--	--	--

Plani i prodhimit:

	njësi		orë
Produkti C	10,700	x 17.6/10€	18,832
Produkti B	9,000	x 16.5/10€	14,850
Produkti A	545	x 24.2/10€	1,318

			35,000

(b)(ii) Fitimi neto

		€	€
Kontributi:			
Produkti A	545 njësi me € 43.40	23,653	
Produkti B	9,000 njësi me € 30.05	270,450	
Produkti C	10,700 njësi me € 38.35	410,345	704,448

Kostot fikse:			
Produkti A	1,000 njësi me € 34.30	34,300	
Produkti B	9,000 njësi me € 25.70	231,300	
Produkti C	10,700 njësi me € 27.20	291,040	556,640
		-----	-----
Fitimi neto			€ 147,808

Problemi 5 (20 pikë)

Korporata Becton Labs LLC, merret me prodhimin e produkteve laboratorike për shfrytëzim industrial. Një produkt, i njohur me emrin "Fludex" ka këto të dhëna standard (kartela e kostove standarde):

	Sasia standarde	Cmimi standard apo norma	Kosto standard
Materiali direct	2.5 kg	20€ për kg	50€
Puna direkte	1.4 orë	12.5€ për orë	17.5€
SHPP variabile	1.4 orë	3.5€ për orë	4.9€
		TOTALI	72.4€

Gjatë muajit nëntor, këto aktivitete janë regjistruar në sistemin e kontabilitetit lidhur me produktin "Fludex":

-Materialet e blera: 12,000 KG me një kosto totale €225,000.

-Nuk ka pasur stoqe fillestare të materialeve; sidoqoftë, në fund të muajit nëntor, 2,500KG kanë ngelur si stoqe përfundimtare të materialeve (lëndës së parë).

-Kompania punëson 35 teknik laborantë të cilët merren me prodhimin e produktit në fjalë. Gjatë muajit nëntor, ata kanë punuar mesatarisht rreth 160 orë, me një normë page mesatare prej 12€/orë.

-SHPP variabile absorbohet në produktet e prodhuara bazuar në orët e punës direkte. SHPP variabile gjatë muajit nëntor ishte 18,200€.

-Gjatë muajit nëntor, janë prodhuar 3,750 njësi 'Fludex'.

Menaxhmenti i korporatës, dëshiron të dijë më shumë rreth efikasitetit të aktiviteteve prodhuese për produktin 'Fludex'.

Kërkohet:

a) Për materialin direkt i përdorur për prodhimin e produktit "Fludex"

a1) Përlllogarisni variancën në cmim dhe sasi.

(4 pikë)

a2) Materialet janë blerë nga një furnitor i ri, i cili dëshiron të hyjë në marrëveshje afatgjatë me korporatën tone. A do ti rekomandonit menaxhmentit që të hyjë në kontratë afatgjatë me këtë furnitor? Shpjegoni.

(3 pikë)

b) Për punën direkte të përdorur për prodhimin e produktit "Fludex"

b1) Përlllogarisni variancën e efikasitetit dhe normës (pagesës).

(4 pikë)

b2) Në të kaluarën, 35 të punësuarit, janë përbërë nga 20 teknik me përvojë të lartë dhe 15 asistentë. Gjatë muajit nëntor, ka zovgëluar numrin e ekspertëve dhe ka rritur numrin e asistentëve, në mënyrë që të reduktoj kostot. A mendoni që ky vendim i strukturës së laborantëve (me përvojë / asistentë) duhet të vazhdohet? Shpjegoni?

(3 pikë)

c) Përlllogarisni variancën e SHPP variabile të efikasitetit dhe normës (pagesës). Qfarë ndërlidhje mund të vëreni ndërmjet variances së efikasitetit të SHPP variabile dhe variancës së efikasitetit të punës direkte? Shpjegoni.

(6 pikë)

Zgjidhja 5

a)

a1)

Varianca e cmimit të MD = SA * (CA - CS)

$$12,000 \text{ KG} * (18.75\text{€}/\text{KG} - \$20.00 \text{ per ounce}) = \$15,000 \text{ F}$$

$$*\text{€}225,000 \div 12,000 \text{ KG} = 18.75\text{€}/\text{KG}$$

Varianca e sasisë së MD = CS * (SA - SS)

$$20.00\text{€}/\text{KG} * (9,500 \text{ KG} - 9,375 \text{ KG}) = \text{€}2,500 \text{ PF}$$

a2) Po, kontrata duhet të nëshkruhet. Cmimi i ri prej 18.75€/kg është shumë më i ulët sesa cmimi paraprak (standard) prej 20€/kg, që rezultoi në një variancë të favorshme (kursim) të cmimit prej €15,000 në muaj. Gjithashtu, materiali prej furnitorit të ri duket që ka shkaktuar pak problem, pasi që ka rezultuar në një variancë të pafavorshme të sasisë prej 2,500€ në muaj. Sidoqoftë, meqenëse varianca e cmimit (F) është shumë më e lartë sesa varianca e sasisë (PF), atëherë kontrata duhet të nënshkruhet.

b)

b1)

Varianca e normës së PD = SA (CA - CS)

$$5,600 \text{ orë} * (12.00\text{€}/\text{orë} - 12.50\text{€}/\text{orë}) = 2,800\text{€ F}$$

Varianca e efikasitetit të PD = CS (SA - SS)

$$12.50\text{€}/\text{orë} * (5,600 \text{ orë} - 5,250 \text{ orë}) = 4,375\text{€ PF}$$

b2)

Jo, ky vendim i strukturës së laborantëve nuk duhet të vazhdohet. Edhe pse ky vendim ndikoi në zvogëlimin e cmimit mesatar për orë të paguar nga 12.5€ në 12.0€, duke shaktuar kështy një variancë të favorshme prej €2,800 (kursim), kjo nuk arsyetohet për faktin që varianca e pafavorshme e efikasiteti të tyre ishte 4,375€.

c)

Varianca e SHPP variabile = SA (CA - CS)

$$5,600 \text{ orë} (3.25\text{€}/\text{orë}* - 3.50\text{€}/\text{orë}) = \$1,400 \text{ F}$$

$$*\text{€}18,200 \div 5,600 \text{ orë} = 3.25\text{€}/\text{orë}$$

Varianca e efikasitetit të SHPP variabile = CS (SA - SS)

$$3.50\text{€}/\text{orë} (5,600 \text{ hours} - 5,250 \text{ hours}) = \$1,225 \text{ PF}$$

Varianca e efikasitetit të SHPP dhe varianca e efikasitetit të PD përlogariten duke krahasuar orët aktuale të punës ndaj orëve standard të punës. Andaj, nëse varianca e efikasitetit të SHPP variabile është e pafavorshme, atëherë edhe varianca e efikasitetit të PD është e pafavorshme.